



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilaški Savet Kosova/ Kosovo Prosecutorial
Council

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të neni 1 par. 4 dhe nenit 22 të Ligjit nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës “Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” nr. 83 dt. 29 tetor 2010 si dhe nenit 11 të Ligjit nr. 05/L-035 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës “Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” nr. 17 dt. 30 qershor 2015, në mbledhjen e mbajtur më 31 mars 2016, miraton:

RREGULLORE NR. 03/2016

Për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve të Shtetit

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Qëllimi i kësaj rregullore është përcaktimi i kriterëve dhe procedurave për transferimin dhe avancimin e prokurorëve të shtetit.
2. Kjo rregullore zbatohet për Prokurorin e Shtetit, përfshirë të gjitha nivelet, në pajtim me Ligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe Ligjin për Prokurorin e Shtetit.

Neni 2

Shkurtesat dhe Përkufizimet

Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë kuptimet si më poshtë:

“KPK” - Këshillin Prokurorial të Kosovës;

“PSH” - Prokurorin e Shtetit;

“ZKPSH” - Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit;

“Ligji” - Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës;

“KPSH” - Kryeprokurori i shtetit;

“PSRK” - Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës;

“NJSHPP” - Njësitin për Shqyrtimin e Përfomancës së Prokurorisë;

“Komisioni” - nënkupton Komisionin për transferimin dhe avancimin e prokurorit të shtetit;

“Transferimi i përkohshëm” - nënkupton transferimin e një prokurori me afat të kufizuar kohor;

“Transferimi i përhershëm” - nënkupton transferimin e një prokurori nga një Prokurori Themelore në një tjetër Prokurori Themelore ose nga një departament në një departament tjetër të nivelit të njëjtë dhe nën kushte të njëjta. Transferimi nënkupton edhe transferimin në departament të nivelit më të ultë me kërkesën e prokurorit;

“Avancimi” - nënkupton ngritjen në detyrë të një prokurori nga një prokurori e nivelit “më të ulët” në atë të nivelit “më të lartë”.

“Departament i Specializuar” - nënkupton Departamentin e Krimeve të Rënda dhe Departamentin për të mitur.

Neni 3 Parimet themelore

1. Avancimi dhe transferimi i prokurorëve bëhet sipas procedurës objektive dhe të paanshme duke përjashtuar mundësinë e diskriminimit në bazë të gjinisë, racës, gjuhës, religjionit dhe përkatësisë kombëtare.
2. Zhvillimi në karrierë i prokurorëve, avancimi i tyre dhe transferimi duhet të bazohen në kriteret objektive siç janë: aftësitë profesionale, merita dhe përvoja profesionale.
3. Zhvillimi në karrierë, avancimi dhe transferimi, duhet të bëhen vetëm sipas ligjit dhe kësaj Rregulloreje dhe me pëlqimin e prokurorëve.

Neni 4 Shpallja e brendshme për transferim dhe avancim

1. KPK mund të bëjë shpalljen e pozitive të lira dhe atë së paku dy herë në vit për transfer dhe avancim të prokurorëve. Në gjashtëmujorin e parë nga muaji janar deri në qershor dhe në gjashtëmujorin e dytë nga muaji korrik deri në dhjetor.
2. Shpallja e pozitive për transfer dhe avancim bëhet përmes faqes zyrtare të KPK-së dhe faqes zyrtare të Prokurorit të Shtetit.
3. Prokurori në çdo kohë mund të parashtojë kërkesë KPK-së për transferim.
4. Për pozitave të lira për transferim dhe avancim në raste të pensionimit të ndonjë prokurori, KPK bënë shpalljen së paku 3 (tre) muaj para pensionimit të prokurorit.

5. Shpallja e brendshme për transferim dhe / ose avancim do të përfshijë informatat në vijim:
 - 5.1 numrin e vendeve të lira për transferim dhe /ose avancim dhe prokuroritë përkatëse;
 - 5.2 përshkrimin e pozitës;
 - 5.3 kriteret rreth kualifikimit për pozitën; dhe
 - 5.4 afatin për dorëzimin e kërkesës.

Neni 5

Transferimi i përhershëm i prokurorëve

1. Prokurori parashtron kërkesë për transferim të përhershëm sipas kushteve të përcaktuara me këtë Rregullore, si në vijim:
 - 1.1. nga një departament i prokurorisë në departamentin e prokurorisë tjetër të nivelit të njëjtë.
 - 1.2. nga Departamenti për të mitur në Departamentin për krime të rënda ose anasjelltas.
 - 1.3. nga një departament i specializuar në Departamentin e Përgjithshëm.

Neni 6

Kriteret për transferim të përhershëm të prokurorëve të shtetit

1. Për transferim të përhershëm mund të aplikojnë vetëm prokurorët të cilët kanë mandat të përhershëm.
2. Përveç kualifikimeve të përcaktuara me ligj dhe këtë Rregullore, prokurorët që aplikojnë për transferim duhet të plotësojnë edhe kriteret si në vijim:
 - 2.1 T'i plotësojnë kriteret ligjore për pozitën që aplikojnë dhe
 - 2.2 Të kenë vlerësim pozitiv të performancës.
3. Komisioni me rastin e vendosjes për transferim të përhershëm merr parasysh edhe përvojën e punës dhe vendbanimin.
4. Me rastin e vendosjes për transferim të përhershëm merret edhe mendimi i kryeprokurorit të prokurorisë nga e cila kërkohet transferimi.

Neni 7

Transferimi i përkohshëm dhe transferimi sipas detyrës zyrtare

1. Me kërkesë të Kryeprokurorit të prokurorisë përkatëse dhe vendim të KPK-së një prokuror i cili i plotëson kriteret, mund të transferohet përkohësisht brenda të njëjtës prokurori apo nga një prokurori në tjetrën, për një periudhë jo më të gjatë se gjashtë (6) muaj.
2. Në raste të jashtëzakonshme Kryeprokurori i Shtetit mund ta transferoj sipas detyrës zyrtare një prokuror nga një prokurori në tjetrën për një periudhë jo më

të gjatë se tridhjetë (30) ditë përveç nëse KPK miraton një periudhë më të gjatë.

Neni 8 Avancimi i Prokurorëve

1. Pas shpalljes së brendshme prokurori parashtron kërkesë për avancim pranë KPK-së, sipas kriterëve të përcaktuara si në vijim:
 - 1.1 Nga Departamenti i Përgjithshëm në Departamentin e krimeve të rënda apo për të mitur brenda një prokurorie apo prokurorisë tjetër.
 - 1.2 Nga njëri departament i prokurorisë themelore në njërin departament të Prokurorisë së Apelit.
 - 1.3 Nga departament i krimeve të rënda të prokurorisë themelore apo Prokurorisë së Apelit në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës.
 - 1.4 Nga njëri departament i prokurorisë themelore, Prokurorisë së Apelit apo nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës në zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit.

Neni 9 Kriteret për avancimin e Prokurorëve të Shtetit

1. Për avancim mund të parashtrorj kërkesë vetëm prokurorët të cilët kanë mandat të përhershëm.
2. Përveç kriterëve të përcaktuara me ligj, prokurorët që parashtrorj kërkesë për avancim duhet të plotësojnë edhe kriteret si në vijim:
 - 2.1 Të kenë vlerësim pozitiv të përfomancës dhe
 - 2.2 Të mos ketë të shqiptuar masë disiplinore, përveç qortimit.
3. Pjesëmarrja ne trajnime në fushën specifike që ndërldhet me pozitën për të cilën është kërkuar avancimi në procedurë penale, mjete juridike, praktika juridike e gjykatave vendore dhe ndërkombëtare do te merret parasys.

Neni 10 Mënyra e aplikimit për transferim dhe avancim

1. Pas shpalljes së brendshme nga KPK, kandidati për transferim apo avancim duhet që në afat prej 15 ditësh t'i dorëzoj Sekretariatit të KPK-së kërkesën për transferim apo avancim.
2. Kërkesa mund të dërgohet me postë ose personalisht në Sekretariatin e KPK-së.

Neni 11 Dokumentet ne mbështetje të kërkesës për avancim

1. Prokurori që parashtron kërkesë për avancim duhet të dorëzoj edhe dokumentet si në vijim:
 - 1.1 Vlerësimi i Kryeprokurorit të prokurorisë përkatëse për tre vitet e fundit;
 - 1.2 Certifikatat e pjesëmarrjes në trajnime;

- 1.3 Dokumente apo të dhëna të tjera relevante ose objektivist të verifikueshme, siç janë ato për njohjen e ndonjë gjuhe të huaj, mësimdhënia në nivel universitar, publikimet shkencore, pjesëmarrja në projekte vendore ose ndërkombëtare si ekspert dhe pjesëmarrja në ekiye hetuese.

Neni 12

Tërheqja e kërkesës për avancim dhe transferim

Në çdo kohë deri në momentin e vendimit të KPK-së, kandidati mund ta tërheqë kërkesën e tij për avancim dhe transferim.

Neni 13

Komisioni për avancim dhe transferim të prokurorëve

1. Me qëllim të zbatimit të kësaj Rregulloreje KPK themelon Komisionin për Transferim dhe Avancim të prokurorëve në bazë të kriterëve të përcaktuara me këtë Rregullore.
2. Komisioni përbëhet nga 3 anëtarë si në vijim:
 - 2.1 Kryeprokurori i Shtetit, i cili do të jetë kryesues;
 - 2.2 Një prokuror nga radhët e anëtarëve të Këshillit, dhe
 - 2.3 Një prokuror nga Prokuroria e Apelit.
3. Komisioni do të ketë anëtarët rezervë dhe atë:
 - 3.1 Një prokuror nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit;
 - 3.2 Një prokuror nga radhët e anëtarëve të Këshillit, dhe
 - 3.3 Një prokuror nga Prokuroria e Apelit.
4. Komisioni do të mbështetet nga Sekretariati i KPK-së dhe do të ketë Sekretarin e Komisionit, të cilin e cakton KPK.

Neni 14

Kompletimi i dosjeve për avancimin e prokurorëve

1. NJSHPP në afat prej 15 ditësh nga dita e mbylljes së konkursit i paraqet Komisionit të dhënat për:
 - 1.1 Vlerësimin e performancës së prokurorit, të siguruara nga NJSHPP;
 - 1.2 Përvojën e mëparshme të punës së kandidatit;
 - 1.3 Trajnimet e ndjekura, të siguruara nga NJSHPP;
 - 1.4 Specializimin në lëminë e caktuar;
 - 1.5 Masat disiplinore të shqiptuara ndaj prokurorit;
2. Komisioni mund të kërkojë informata shtesë nga prokurori, prokuroria apo nga NJSHPP.

Neni 15
Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit

1. Komisioni shqyrton të gjitha kërkesat dhe dokumentet e dorëzuara në pajtim me shpalljen e brendshme për transfer dhe avancim të prokurorëve dhe të dhënat e ofruara nga NJSHPP.
2. Pas shqyrtimit e të gjitha të dhënave të kandidatëve, Komisioni harton një listë me të gjithë kandidatët që I përmbushin kriteret për transfer dhe avancim.
3. Komisioni i vlerëson të gjithë kandidatët për transfer të cilët I plotësojnë kriteret.
4. Komisioni vlerëson dhe interviston të gjithë kandidatët për avancim, të cilët I plotësojnë kriteret.
5. Komisioni poenton kandidatët duke përdorur tabelat me sistemin e poentimit për kandidatët për transfer dhe avancim siç parashihet në Aneks I dhe Aneks II, të cilat janë pjesë integrale të kësaj rregullorje.
6. Komisioni harton raportin final me listën e kandidatëve të propozuar për transfer apo avancim duke u bazuar në renditjen në pajtim me paragrafin 6, i cili i dërgohet KPK Brenda 7 ditëve për miratim.
7. Komisioni njofton prokurorin për rezultatin e procesit të vlerësimit brenda 7 ditëve.

Neni 16
Kundërshtimi i prokurorit ndaj raportit të Komisionit

Kundër raportit përfundimtar të Komisionit për Transferim dhe Avancim, prokurori ka të drejtë kundërshtimi me shkrim pranë KPK-së, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të vendimit.

Neni 17
Vendimi i KPK-së

1. KPK do të vendosë për kundërshtimin brenda 10 ditëve nga dita e pranimit të Kundërshtimit ose në takimin e parë të KPK-së.
2. Nëse vendimi i KPK-së rezulton me ndryshim të Raportit të Komisionit mbi avancimin apo transferimin e prokurorit i cili paraqet kundërshtimin, KPK do të publikojë vendimin përfundimtar së bashku me raportin e ndryshuar.
3. KPK vendosë me shumicë të thjeshtë votash lidhur me avancimin apo transferimin e prokurorëve. Vendimi i KPK-së publikohet në faqen zyrtare të KPK-së dhe të PSH-së.

Neni 18
Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

1. Kjo Rregullore shfuqizon të gjitha rregulloret në fuqi të cilat kanë rregulluar çështjet lidhur me transferimin dhe avancimin e prokurorëve.
2. Kjo Rregullore mund të ndryshohet dhe plotësohet me vendim të KPK-së.

Neni 19
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga KPK.

Prishtinë, më 31 mars 2016


Blerim Isufaj
Kryesues
Këshilli Prokurorial i Kosovës



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës / Tužilaški Savet Kosova / Kosovo Prosecutorial Council

KOMISIONI PËR AVANCIMIN DHE TRANSFERIN E PROKURORËVE

SHTOJCA 2

Formulari për vlerësimin e prokurorëve për avancim

FORMULAR I VLERËSIMIT

Dosja Nr..../2016

Data:../.../2016

PJESA I: INFORMATA TË PËRGJITHSHME

(Informatat në Pjesën I-rë, duhet të plotësohen nga Komisioni Vlerësues)

Emri:

Data e Lindjes:

Pozita/ Departamenti:

1. VLERËSIMIN E PËRFORMANCËS SË PROKURORIT

(Shpjegim i shkurtër Vlerësimin e performancës së prokurorit, të siguruar nga NJSHPP)

--

2. INTERVISTIMI

(Shpjegim i shkurtër në lidhje me intervistimin e kandidatit)

--

3. PËRVOJA E PUNËS

(Shpjegim i shkurtër i përvojës së mëparshme të punës së kandidatit)

--

4. TRAJNIMET

(Shpjegim i shkurtër për trajnimet e ndjekura, të siguruar nga NJSHPP)

--

5. SPECIALIZIMET

(Shpjegim i shkurtër për Specializimin në lëminë e caktuar)

--

6. MASAT DISIPLINORE

(Shpjegim i shkurtër për Masat disiplinore të shqiptuara ndaj prokurorit)

--

Tabela e poentimit

NR.	Kriteret	Piket	Vlerësimi
1	Vlerësimi i Përformancës së Prokurorit	Max. 35	
2	Intervistimi	Max. 25	
2	Përvoja e Punës	Max. 20	
3	Trajnimet	Max. 10	
4	Specializimet	Max. 10	

Kryesuesi i Komisionit Vlerësues:

Emri dhe Mbiemri

Nënshkrimi

Data

Anëtari i Komisionit Vlerësues :

Emri dhe Mbiemri

Nënshkrimi

Data

Anëtari i Komisionit Vlerësues:

Emri dhe Mbiemri

Nënshkrimi

Data